

Çdo qytet ka duhmën e vet të vuajtjes.

Por pak nga banorët e Meslumasit e njohën kutërbimin e asaj pasditeje të vakët shtatori. Disave iu duk si aromë vjeshte që vinte nga kazanët e pijeve alkoolike. Të tjerë menduan se është duhma e djegies së ndonjë prej magazinave të periferisë, apo të plehrave të qytetit, të hedhura në stomet afër varrezave. Të tjerëve u kujtoi thartimën e pleqve të braktisur.

Por çuditërisht, askujt nuk i shkoi ndërmend dhe hunda e askujt nuk e dalloj dot erën e kalbëzimit që shpërtheu pas një plasjeje të shurdhër dhe cingëritjes së xhamave të thyer. Nga dritaret e shkatëruara, kutërbimi i kalbëzimit u përhap në rrugë dhe rrugica, nëpër shkallët e pallateve, në shitore dhe pijetore, në hapësirat e administratorëve dhe në libraritë, në bordellon ilegale dhe galerinë e vetme të arteve figurative.

Të gjithë nxituan të mbyllin dritaret...

Namik Dokle

10 gramë nder



BOTIMET
TOENA
TIRANË

Namik Dokle

10
gramë
nder